



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr.15, datë 20.02.2017

**“PËR MIRATIMIN E TREGUESVE TË REALIZIMIT TË BUXHETIT  
TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2014 ”.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” ; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.1, datë 26.02.2014 për “ Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014”; Urdhresës Nr. 80 datë 28.01.2013 për “ Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë së Tiranës” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë treguesit e realizimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014 sipas relacioneve dhe pasqyrave nr.1, 2, 3 dhe nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**